



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Njësia Nr./Br./No 01(Kuvendi i Komunës)

Nr./Br./No 01/170 Nr. i faq./Br.str/No.pg 31

Data/Date 27.07.2026

Në mbështetje të nenit 12 pika 1 dhe pika 2 shkronja d), nenit 14 pika 1, nenit 17 shkronja (c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008"), Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 52/2009"), nenit 24 i Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019"), nenit 29 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 paragrafi 2 pika 2.11, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017 dhe pëlqimit parimor të Agjencionit Kosovar të Privatizimit me Nr. 4160AV e datës 14.07.21026, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 23.7.2026 miraton këtë:

V E N D I M

Shpalljen me interes të përgjithshëm publik të pjesës së parcelës P-71510018-00428-2 në Zonën Kadastrale Dejnë

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës me Nr. Prot. 02/7507 i datës 15. 6.2026 dhe shpallet interes i përgjithshëm publik pjesa e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë P-71510018-00428-2 në Zonën Kadastrale Dejnë, në sipërfaqe prej 4500m² (katërmijë e pesëqind metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 10459m² (dhjetëmijë e katërqind e pesëdhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të P.SHE KOSOV.K.K.RAHOVEC- SHFRY.N.B.I.RAHOVECI.
2. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës së cekur në pikën 1 të këtij vendimi është fillimi i procedurës së shpronësimit, për zgjerimin e infrastrukturës së Festivalit "Anadrinia Jehon" në Dejnë.
3. Autorizohet Kryetari i Komunës që komform dispozitave ligjore në fuqi të ndërmer të gjitha veprime të nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.
4. Bartës për rregullimin e dokumentacionit teknik dhe regjistrimin e pronës në Librin Kadastral do të jetë Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Rahovecit.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenit 8 dhe nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2026 për procedurën e shqyrtimit administrativ të akteve të komunave dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Kryetarit të Komunës,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËSNË RAHOVEC

01Nr.170/26
Datë:23.07.2026

